

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 20.11 .2012 me drejtoritë komunale, duke u bazuar në vendimin e Kuvendit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-12557, të datës 15.11.2012, lidhur me udhëtimin dhe akomodimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit dhe të një pjese të stafit të ekzekutivit, për në Republikën e Shqipërisë, për nder të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, mori këtë

K O N K L U Z I O N

Lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse, lidhur me udhëtimin dhe akomodimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit dhe të një pjese të stafit të ekzekutivit të Komunës së Prizrenit, për në Republikën e Shqipërisë për nder të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë nga data 26 nëntor deri me 29 nëntor 2012.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Financave dhe Ekonomisë.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 20.11.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës – Zyrës për Çështje Gjinore, rreth lejimit të mjeteve financiare për organizimin e aktiviteteve me rastin e fushatës kundër dhunës ndaj grave, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës-Zyra për Çështje Gjinore rreth lejimit të mjeteve financiare për organizimin e aktiviteteve me rastin e fushatës kundër dhunës ndaj grave, e cila fushatë do të zgjatë prej datës 25.11.2012 deri me 10.12.2012, kështu që, për këtë qëllim lejohen 100 € për pagesë të ligjëruesit për dy ligjërata dhe lejohen 100 € për mbulimin e shpenzimeve për dy kokteje.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Drejtoria e Administratës - Zyra për Çështje Gjinore dhe Drejtoria e Financave dhe Ekonomisë.

Me këtë konkluzion të njoftohen Drejtoria e Administratës - Zyra për Çështje Gjinore, Drejtoria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 20.11.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës - Zyrës për Çështje Gjinore, të datës 12.11.2012, rreth lejitimit të mjeteve financiare për mbështetje të fushatës kundër kancerit në gji, si dhe për lirim nga participimi i nëpunësve të Komunës së Prizrenit për realizimin e kontrolleve mjekësore në QKMF, me anë të ultrazërit dhe mamografisë, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës - Zyrës për Çështje Gjinore, i datës 12.11.2012, rreth lejitimit të mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të organizimit të fushatës kundër kancerit në gji, kështu që për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të pagesës së ligjërueses lejohen mjetet në shumën prej 100 €.

Nëpunëset e Komunës së Prizrenit lirohen nga participimi për realizimin e kontrolleve mjekësore në QKMF, me anë të ultrazërit dhe mamografisë gjatë kësaj fushate.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Drejtoria e Administratës - Zyra për Çështje Gjinore dhe Drejtoria e Financave dhe Ekonomisë.

Me këtë konkluzion të njoftohen Drejtoria e Administratës - Zyra për Çështje Gjinore, Drejtoria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Në bazë të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të parashtruar nga Drejtoria e Administratës rreth formimit të Komisionit për vlerësimin e pasurive komunale për vitin 2012, kryetari i Komunës, mori këtë

A K T V E N D I M

I. Miratohet propozimi i parashtruar nga Drejtoria e Administratës rreth formimit të Komisionit për vlerësimin e pasurive komunale për vitin 2012. Për anëtarë të këtij komisioni, emërohen: 1. Fejsal Hoti, kryetar, 2. Alban Susuri, dhe 3. Shyhrete Kovaq, anëtarë.

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit nga pika I e këtij Aktvendimi do të jenë ato që janë paraparë me nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 21/2009 për Menaxhimin e Pasurisë Qeveritare.

III. Ky Komision, për punën e bërë do të raportojë me shkrim para organeve kompetente të Komunës së Prizrenit.

IV. Pas raportimit me shkrim për punën e bërë, anëtarët e Komisionit do të kompensohen nga KK-ja, dhe se puna e komisionit llogaritet si punë jashtë orarit të rregullt të punës.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të këtij aktvendimi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen Drejtoria e Administratës dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen Drejtoria e Administratës, të emëruarit dhe Arkivi.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Në bazë të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të parashtruar nga Drejtoria e Administratës rreth formimit të Komisionit për regjistrim të inventarit dhe pajisjeve të tjera - pronë komunale për vitin 2012, kryetari i Komunës mori këtë:

A K T V E N D I M

Për formimin e Komisionit për regjistrim të inventarit dhe pajisjeve të tjera-pronë komunale për vitin 2012

I. Miratohet propozimi i parashtruar nga Drejtoria e Administratës rreth formimit të Komisionit për regjistrimin dhe evidentimin e mjeteve themelore-inventarit dhe pajisjeve të tjera në të gjitha objektet e Komunës së Prizrenit për vitin 2012. Për anëtarë të këtij komisioni, emërohen: 1. Naim Kukaj, kryetar, 2. Merita Gorani, 3. Sherife Çengaj, 4. Ylber Gashi, 5. Haxhere Gavazaj, 6. Kujtim Gashi, 7. Hava Berisha, 8. Alban Hamzaj, 9. Merita Besimi, 10. Azem Bilibani, 11. Bashkim Lubovci dhe 12. Fail Hoxha, anëtarë. Komisioni i lartcekur duhet të mbështetet edhe nga shërbimi i furnizimit të KK-së.

II. Komisioni nga pika I e këtij Aktvendimi do të bëjë regjistrimin dhe evidentimin e inventarit në këto objekte: Objekti i Ekzekutivit të KK-së, objekti i ndërtesës së Kuvendit të Komunës, zyrat e Drejtorisë së Arsimit dhe të Shkencës, të Drejtorisë së Ekonomisë dhe të Financave, zyrat e Gjendjes Civile dhe objektet e tjera që menaxhohen nga Kuvendi i Komunës.

III. Ky Komision, për punën e bërë, do të raportojë me shkrim para organeve kompetente të Komunës së Prizrenit.

IV. Puna e komisionit llogaritet si punë jashtë orarit të rregullt të punës dhe se për punën e bërë, anëtarët e Komisionit do të kompensohen nga ana e KK-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen Drejtoria e Administratës dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen Drejtoria e Administratës, të emëruarit dhe Arkivi.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 20.11.2012 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës, të datës 23.10.2012, rreth lejitimit të shpalljes së tenderit për studimin e fizibilitetit për Qendrën Sportive “Sezai Surroi”, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, i datës 23.10.2012, rreth lejitimit të studimit të fizibilitetit për Qendrën Sportive “Sezai Surroi” në Prizren, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Pagesa bëhet nga pozicioni i Drejtorisë së Shërbimeve Publike-kodi: studimi i fizibilitetit;

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 20.11.2012 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës, të datës 8.11.2012, rreth lejitimit të shpalljes së tenderit për ndërtimin e Kompleksit të Dëshmorëve në varrezat e Landovicës, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, i datës 8.11.2012, rreth lejitimit të ndërtimit të Kompleksit të dëshmorëve në varrezat e Landovicës, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-zyrtar
Më 12.11.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës -Zyra e Personelit, rreth lejimit të organizimit të një punëtorie nga ana e Komisionit për klasifikimin e vendeve të punës dhe të lejimit të mjeteve për organizimin e kësaj punëtorie, kryetari i Komunës, më 12 nëntor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës -Zyra e Personelit, rreth lejimit të organizimit të një punëtorie nga ana e Komisionit për klasifikimin e vendeve të punës dhe të lejimit të mjeteve për organizimin e kësaj punëtorie. Kështu që, lejohet që ky komision ta organizojë këtë punëtori lidhur me hartimin sa më të shpejtë të vendimit për klasifikimin e vendeve të punës në Komunën e Prizrenit. Andaj, në emër të mbulimit të shpenzimeve (udhëtimit, akomodimit dhe ushqimit) që kanë të bëjnë me organizimin e punëtorisë së lartcekur, lejohen mjetet e nevojshme financiare, si dhe lejohet zhvillimi i procedurave të tjera ligjore.

Kjo punëtori do të organizohet në Republikën e Shqipërisë dhe do të zgjasë 5 ditë.

Në këtë punëtori do të marrin pjesë anëtarët e komisionit të formuar me aktvendim nr. 01/011-6243 të datës 6.6.2012 në këtë përbërje: 1. Osman Hajdaraj-udhëheqës i Zyrës së Personelit, kryetar i Komisionit, 2. Ragip Gajraku-jurist, 3. Zenel Ahmetaj, ekonomist, 4. Arben Shala, jurist dhe 5. Visar Islamaj, jurist, si dhe anëtarët plotësues të këtij komisioni, me aktvendim nr. 01/06-8744 datë 14.8.2012. në këtë përbërje: Igbalka Rama dhe Xhengiz Gjurgjealo.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës - Zyra e Personelit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës - Zyra e Personelit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 20.11.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të datës 9.11.2012, rreth lejit të shpalljes së tenderit për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit në fshatin Krajk, me participim, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 9.11.2012, rreth lejit të ndërtimit të rrjetit të kanalizimit në fshatin Krajk, me participim, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për realizimin e këtyre projekteve, Komuna e Prizrenit do të participojë me 70 % të vlerës së projektit, ndërsa komuniteti me 30 %.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike për formimin e Komisionit për vlerësimin e automjeteve të konfiskuara që gjenden në parkun e automjeteve të dy operatorëve, kryetari i Komunës, më 20 nëntor 2012, miratoi këtë:

A K T V E N D I M

I. Formohet dhe emërohet Komisioni për vlerësimin e automjeteve të konfiskuara nga ana e policisë që gjenden në parkun e automjeteve të dy operatorëve. Për anëtarë të këtij Komisioni, emërohen:

1. Përparim Shala, kryetar i Komisionit,
2. Sadik Tahiri dhe
3. Zekë Tejeci, anëtarë.

II. Detyrat e Komisionit do të jenë: Të bëjë vlerësimin e automjeteve të konfiskuara, t'ju caktojë çmimin fillestar për shitje nëpërmjet ankandit të këtyre automjeteve dhe të hartojë procesverbalin përkatës me propozim për shitje.

III. Komisioni, nga pika I e këtij Aktvendimi, do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me ligjin në fuqi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen Drejtoria e Shërbimeve Publike, të emëruarit dhe Arkivi.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 20.11.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për miratimin e Raportit të komisionit, i cili ka bërë vlerësimin e drunjve ekzistues dekorativ në “Kompleksin e Marashit”, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet Raporti i komisionit, i cili ka bërë vlerësimin e drunjve ekzistues dekorativ në “Kompleksin e Marashit”, si dhe miratohen rekomandimet e propozuara të komisionit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, komisioni dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, komisioni, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, rreth lejitimit të udhëtimit zyrtar për në Tiranë të Republikës së Shqipërisë dhe pagesës së mëditjeve për Fejsal Hotin, kryetari i Komunës, më 20 nëntor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejitimin e udhëtimit zyrtar të Fejsal Hotit për në Tiranë të Republikës së Shqipërisë, me qëllim të pjesëmarrjes në Konferencën e 12 –të, të Shoqatës së Ujësjetës dhe Kanalizimeve të Shqipërisë, që do të mbahet nga data 6 nëntor deri me 8 nëntor 2012. Kështu që, për këtë qëllim, lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurin.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 20.11.2012 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, të datës 12.11.2012, rreth lejimit të shpalljes së tenderit për punimin dhe vendosjen e tabelës rrugore dhe pllakës informuese “Rruga antike-Via de Zenta” pranë murit rrethues në Hamamin e “Gazi Mehmet Pashës”, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, i datës 12.11.2012, rreth lejimit të punimit dhe vendosjes së tabelës rrugore dhe pllakës informuese “Rruga antike-Via de Zenta” pranë murit rrethues në Hamamin e “Gazi Mehmet Pashës”, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 20.11.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, të datës 12.11.2012, rreth lejimit të shpalljes së tenderit për riparimin e tabelave informuese në qytetin e Prizrenit, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, i datës 12.11.2012, rreth lejimit të riparimit të tabelave informuese, të cilat janë të vendosura në qytetin e Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit rreth lejitimit të organizimit dhe shënimit të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, si dhe mbulimit të shpenzimeve me rastin e shënimit të këtij manifestimi, kryetari i Komunës, më 20 nëntor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe lejohet organizimi dhe shënimi i 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, si dhe lejohen mjetet e nevojshme financiare për mbulimin e shpenzimeve lidhur me organizimin dhe shënimin e këtij 100-vjetori. Mjetet lejohen pas parashtrimit të faturave.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, rreth lejitimit të mjeteve financiare për realizimin e dokumentarit kushtuar Dëshmorit të Kombit, Tahir Sinani, kryetari i Komunës më 20 nëntor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në kërkesën e Multimedia “IDEA”, rreth lejitimit të mjeteve financiare për realizimin e dokumentarit kushtuar Dëshmorit të Kombit, Tahir Sinani. Kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të bashkëfinancimit në këtë projekt, Komuna e Prizrenit lejon mjetet në shumën 2500 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Inspektorateve për formimin e komisionit për vlerësimin e shpenzimeve në objektin ku janë vendosur përkohësisht punëtorët e kësaj drejtorie, kryetari i Komunës, më 20 nëntor 2012, miratoi këtë:

A K T V E N D I M

I. Formohet dhe emërohet Komisioni për vlerësimin e shpenzimeve në objektin ku janë të vendosur përkohësisht punëtorët e kësaj drejtorie. Për anëtarë të këtij Komisioni, emërohen: 1. Bashkim Krasniqi, kryesues i komisionit, 2. Zeqir Xhaferi, Dukagjin Berisha –anëtarë nga Komuna e Prizrenit, 4. Naim Kastrati, 5. Jakup Zogaj dhe 6, Ramadan Gashi, anëtarë nga Qendra Rajonale e Administratës Pensionale në Prizren.

II. Detyrat e Komisionit do të jenë: të bëjë vlerësimin e shpenzimeve të ngrohjes, rrymës, ujit dhe të shërbimeve të tjera nga ana e punëtorëve të Drejtorisë së Inspektorateve në objektin ku janë të vendosur përkohësisht. Të bëhet edhe matja e hapësirave ku janë vendosur punëtorët e lartcekur të Komunës, të hartojë një raport të përbashkët dhe të propozojë mënyrën dhe formën e ndarjes së shpenzimeve të lartcekura, në mënyrë që të bëhet mbulimi i shpenzimeve.

III. Komisioni, nga pika I e këtij Aktvendimi, do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me ligjin në fuqi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen Drejtoria e Inspektorateve dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen Drejtoria e Inspektorateve, QRAP, të emëruarit dhe Arkivi.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 20.11.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, të datës 15.11.2012, rreth lejitimit të shpalljes së tenderit për transportin e mësimdhënësve udhëtarë të Komunës së Prizrenit, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, i datës 15.11.2012, rreth lejitimit të transportit të mësimdhënësve udhëtarë të Komunës së Prizrenit, të cilët udhëtojnë në relacionet e ndryshme brenda territorit të Komunës së Prizrenit, përkatësisht nga Prizreni në shkollat e fshatrave të komunës dhe anasjelltas, për vitin kalendarik 2013, kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 20.11.2012 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, të datës 15.11.2012, rreth lejimit të shpalljes së tenderit për lyerjen e fasadës së ShFMU “Lekë Dukagjini”, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, i datës 15.11. 2012, rreth lejimit të lyerjes së fasadës së Shkollës Filllore të Mesme të Ultë “Lekë Dukagjini”, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, rreth lejitimit të udhëtimit zyrtar për në Serbi dhe pagesës së shpenzimeve të akomodimit, ushqimit dhe pagesës së mëditjeve për Igbalka Ramën, kryetari i Komunës, më 20 nëntor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejitimin e udhëtimit zyrtar të Igbalka Ramës për pjesëmarrjen në vizitën e quajtur “Shko dhe Informohu”, me qëllim të takimit me personat e zhvendosur të komuniteti serb nga Komuna e Prizrenit, që aktualisht qëndrojnë në Serbi. Vizita do të realizohet nga data 14 nëntor deri me 16 nëntor 2012 në disa qytete të Serbisë, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe mbulimi i shpenzimeve të akomodimit, ushqimit dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurën.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, e lartcekura, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, rreth lejitimit të udhëtimit zyrtar për në Bruksel dhe pagesës së mëditjeve për Sadik Paqarizin, drejtor i DUPH, kryetari i Komunës, më 20 nëntor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejinin e udhëtimit zyrtar dhe pagesës së mëditjeve për Sadik Paqarizin, drejtor i DUPH, me qëllim të pjesëmarrjes në vizitën studimore dhe prezantimit të programit lidhur me konservimin e trashëgimisë kulturore, që do të mbahet nga data 9 dhjetor deri me 13 dhjetor 2012 në Bruksel të Belgjikës. Kështu që, për këtë qëllim, lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurin.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 20.11. 2012 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë rreth lejitimit të shpalljes së tenderit për vendosjen e sistemit të vëzhgimit digjital të qytetit-faza e dytë, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë për lejitimin e vendosjes së sistemit të vëzhgimit digjital të qytetit-faza e dytë, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-12394
Më 20.11.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 20.11. 2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë rreth lejitimit të shpalljes së tenderit për furnizim me pajisje për zjarrfikës, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë për lejitimin e furnizimit me pajisje për punë për nevojat e zjarrfikësve, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja